

URDHËR
Nr. 99, datë 14.5.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR REGJISTRIMIN E FUSHAVE TË
FLUTURIMIT DHE TERRENEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 59, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për regjistrimin e fushave të fluturimit dhe terreneve në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE
**PËR REGJISTRIMIN E FUSHAVE TË FLUTURIMIT DHE TERRENEVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Neni 1
Objekti

1. Kjo Rregullore parashikon:
 - a) Rregullat për regjistrimin e fushave të fluturimit dhe terreneve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.
 - b) Kërkesat për ndërtimin dhe operimin e fushave të fluturimit dhe terreneve në Republikën e Shqipërisë.
2. Autoriteti i Aviacionit Civil kryen vlerësimin dhe regjistrimin e fushave të fluturimit dhe terreneve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fushat e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për fushat e fluturimit dhe terrenit që do të përdoren nga avionë me masë maksimale në ngritje (MTOM) nën 5700 kg, vetëm për operimet e fluturimeve kombëtare, për transport ajror të përgjithshëm, me rregullat vizuale të fluturimit, gjatë ditës (VFR).
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë detyruese për operatorët e fushave të fluturimit dhe terreneve të regjistruara dhe për subjektet që aplikojnë për regjistrimin e këtyre fushave të fluturimit dhe terreneve.
3. Fushat e regjistruara me urdhrin e ministrit nr. 130, datë 9.11.2012, “Për miratimin e rregullore për certifikimin dhe regjistrimin e aerodromeve civilë në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet

dhe përgjegjësitë e operatorëve të aerodromeve”, do të konsiderohen si të regjistruar në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

4. Brenda datës 31 tetor 2024, të gjithë operatorët e regjistruar me urdhrin e ministrit nr. 130, datë 9.11.2012, do të marrin masa për të përmbushur kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 **Termat dhe përkufizimet**

Në kuptim të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)” është autoriteti kompetent përgjegjës për regjistrimin e fushave të fluturimit.

2. “Aerodrom” është një zonë e përcaktuar (përfshirë çdo ndërtesë, instalim dhe pajisje), në tokë, mbi ujë, mbi një strukturë fikse në tokë, apo në det, ose mbi një strukturë lundruese, që do të përdoret tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve mbi sipërfaqe.

3. “Fushë fluturimi” është një zonë e përcaktuar, në tokë ose në ujë, e cila plotëson kushtet e nevojshme për nisjen e mbërritjen e avionëve, që përdoren në bujqësi, pylltari, aktivitete sportive dhe kreative.

4. “Regjistri i fushave të fluturimit dhe terreneve” nënkupton regjistrin e krijuar dhe të mirëmbajtur sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje.

5. “Aeroport” nënkupton një aerodrom, i cili ka nevojë për një zonë të kufizuar në rrethinat e tij, për shkak të natyrës dhe shkallës së trafikut ajror, i cili përdoret për uljen dhe ngritjen e mjeteve ajrore, për marrjen ose zbritjen e pasagjerëve ose të ngarkesave.

6. “Operator i avionit” është personi, i cili përdor avionin, është pronari i avionit, ose personi që ka përdorimin e autorizuar të avionit për qëllimin e operimit të tij.

7. “Punë ajrore” është operimi i një avioni, në të cilin ai përdoret për shërbime të specializuara, të tilla si: bujqësi, ndërtim, fotografim, studim, vëzhgim dhe patrullim, kërkim-shpëtim, reklamime ajrore etj.

8. “Transport ajror i përgjithshëm” janë të gjitha operimet e aviacionit civil të ndryshme nga shërbimet ajrore të programuara dhe operimet ajrore jo të programuara për qëllime fitimi ose me qira.

9. “Operator i fushës së fluturimit dhe terrenit” është subjekti të cilit i është lëshuar nga AAC-ja dokumenti i regjistrimit të fushës së fluturimit dhe terrenit.

10. “Menaxheri raportues” është personi i pranuar nga AAC-ja për të kryer funksionet sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje.

11. “Zonë e mbrojtur” është përcaktimi i hapësirës ajrore përreth aerodromeve, e cila duhet mbajtur e lirë nga pengesat, duke lejuar që operimet e mjeteve ajrore të kryhen në mënyrë të sigurt, të parandalojnë që aerodromet të bëhen të pashfrytëzueshme nga shtimi i pengesave përreth tyre, si dhe të sigurojnë që projektet zhvillimore të ndërtimit në zonat e përcaktuara, në asnjë formë, të mos shkelin kërkesat e sigurisë së lundrimit ajror dhe të jenë në përputhje me operimet në aerodrom.

Neni 4 **Kushtet e përgjithshme për fushat e fluturimit dhe terrenit**

1. Ndërtimi dhe operimi i një fushe fluturimi dhe terreni lejohet vetëm me pëlqimin e pronarit të tokës dhe pas marrjes së të gjitha miratimeve/autorizimeve specifike të parashikuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi.

2. Operimi i një fushe fluturimi dhe terreni të regjistruar duhet të kryhet vetëm sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin e regjistrimit të lëshuar nga AAC-ja.

3. Është përgjegjësi e operatorit ajror të vlerësojë paraprakisht dhe të sigurohet se kushtet e fushës së regjistruar janë të përshtatshme për llojin e operimit që synohet të realizohet, tipin e avionit, siç përshkruhet në manualin e tij të operimit.

4. Përgjegjësia për operimin e sigurt të fushës së fluturimit dhe terrenit, duke përfshirë ruajtjen e të dhënave të regjistrimit dhe përditësimin e informacionit për çdo ndryshim në fushën e fluturimit dhe terrenit, është e operatorit të fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar.

5. Fushat e fluturimit dhe terrenit të regjistruara do të përfshihen në Programin e Mbikëqyrjes së Vazhdueshme të AAC-së, për të verifikuar që kushtet fillestare të regjistrimit dhe kërkesat specifike të vendosura janë ruajtur.

6. Gjatë procesit të regjistrimit të fushës së fluturimit dhe terrenit, përfaqësuesit e AAC-së kanë të drejtë të pakufizuar për të hyrë në të gjitha objektet e fushës së fluturimit dhe terrenit, të inspektojnë objektet, pajisjet dhe infrastrukturën, si dhe të intervistojnë punonjësit.

Neni 5

Kërkesa për regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit

1. Për të regjistruar fushën e fluturimit dhe terrenit, subjekti duhet të dorëzojë në AAC në formë të shkruar, kërkesën për regjistrim.

2. Kërkesa për regjistrim duhet të plotësohet nga subjekti aplikues dhe të jetë në formën e miratuar sipas shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje, si dhe duhet të shoqërohet nga:

a) Informacion i hollësishme lidhur me aplikuesin (të dhënat personale apo të dhënat e personit juridik, adresa);

b) Arsyet e aplikimit për regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit;

c) Emri i zonës, si dhe i vendbanimit më të afërt, koordinatat gjeografike të pikës referuese të shprehura në Sistemin Gjeodezik Botëror-1984 (WGS-84) i verifikuar nga gjeodetë të autorizuar, shoqëruar me hartën e zonës (1:25 000);

d) Deklarata e aplikuesit që karakteristikat fizike të fushës së fluturimit dhe të terrenit janë të përshtatshme për kërkesat teknike të avionëve që do të operojnë në fushën e fluturimit dhe terrenit;

e) Nëse aplikuesi nuk është pronar i tokës, deklaratën e aplikuesit, e shoqëruar nga një dokument zyrtar që vërteton se pronari, poseduesi i fushës së fluturimit dhe terrenit, apo personi juridik/fizik me të drejtën e shfrytëzimit të fushës së fluturimit dhe terrenit, pajtohet që aplikuesi të shfrytëzojë fushën e fluturimit dhe terrenit për ngritje dhe ulje të avionit, dhe me kërkesat e nenit 4, pika 4. Nëse aplikuesi është pronar i tokës, duhet të dorëzojë në AAC certifikatën e pronësisë;

f) Plani me përmasa (harta) i fushës së fluturimit dhe terrenit, me shkallën e përpjesëtimimit të caktuar dhe përshkrimin e shkurtër të sipërfaqes (në dhe, bari etj.) drejtimet më të mira për afrim, ulje dhe ngritje, pengesat e ndjeshme (të cilat mund të ndikojnë në sigurinë në operim) në vetë zonën, apo në zonat përreth;

g) Emrin ose emrat e personit ose të personave që do të jenë menaxherë raportues për fushën e fluturimit;

h) Një deklaratë me shkrim, të nënshkruar nga një person i kualifikuar sipas nenit 9, për të garantuar që:

i. personi të ketë kryer një inspektim të sigurisë (*safety*); dhe

ii. fusha e fluturimit dhe terrenit plotëson standardet e aplikueshme të referuara në këtë Rregullore dhe është e sigurt për operim;

3. Gjatë vlerësimit të kërkesës për regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit, AAC-ja mund të kërkojë dokumente shtesë, sipas nevojës.

Neni 6

Regjistrimi i fushës së fluturimit dhe terrenit

1. AAC-ja bën regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit nëse aplikuesi i plotëson të gjitha kërkesat e përshkruara nga kjo Rregullore.
2. Regjistrimi i fushës së fluturimit dhe terrenit mbetet në fuqi deri në momentin kur ai anulohet.
3. Subjekti të cilit i është refuzuar kërkesa apo ka tërhequr kërkesën për regjistrim të fushës së fluturimit dhe terrenit, mund ta përsërisë kërkesën pasi të jetë eliminuar shkaku i refuzimit apo tërheqjes.
4. Gjatë procesit të regjistrimit, AAC-ja verifikon përshtatshmërinë e fushës së fluturimit dhe terrenit.
5. AAC-ja duhet të regjistrojë fushën e fluturimit dhe terrenit duke futur në Regjistrin e Fushave të Fluturimit dhe Terreneve të dhënat e mëposhtme, në lidhje me:
 - i. emrin e fushës së fluturimit dhe terrenit;
 - ii. detajet e vendndodhjes së fushës së fluturimit dhe të terrenit;
 - iii. emrin dhe adresën e operatorit;
 - iv. pika e referimit të fushës së fluturimit (gjerësia, gjatësia);
 - v. numri i dokumentit të regjistrimit;
 - vi. menaxheri raportues i fushës së fluturimit dhe terrenit.
6. AAC-ja duhet të njoftojë subjektin, me shkrim, që fusha e fluturimit dhe e terrenit është regjistruar.
7. Nëse AAC-ja vendos të mos regjistrojë fushën e fluturimit dhe të terrenit, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit, AAC-ja duhet të njoftojë me shkrim subjektin, për vendimin e marrë dhe arsyet e mosregjistrimit.

Neni 7

Njoftimi dhe raportimi

1. Operator i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar duhet të informojë AAC-në dhe pilotët që operojnë në këtë fushë fluturimi dhe terreni për çdo ndodhi që ka të bëjë me sigurinë dhe sigurimin e trafikut ajror, apo të ndonjë akti në kundërshtim me legjislacionin kombëtar në fuqi, të ndodhur gjatë operimeve të avionit në fushën e fluturimit dhe terrenit të regjistruar.
2. Detajet e regjistrimit dhe informacioni në lidhje me fushën e fluturimit dhe të terrenit të kërkuar nga standardet e kësaj Rregulloreje duhet t'i komunikohen pilotit para çdo uljeje-ngritje nga operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar, si dhe duhet të publikohen në faqen zyrtare të operatorit të fushës së fluturimit dhe terrenit.
3. Operatori i fushës së fluturimit dhe i terrenit të regjistruar, në përputhje me standardet e kësaj Rregulloreje, duhet të njoftojë pilotët që operojnë në këtë fushë fluturimi dhe terreni, për:
 - a) çdo ndryshim të përkohshëm ose të përhershëm në gjendjen fizike të fushës së fluturimit dhe terrenit që mund të ndikojnë në sigurinë e avionëve; ose
 - b) çdo ngjarje tjetër që lidhet me funksionimin dhe mirëmbajtjen e fushës së fluturimit dhe të terrenit që mund të ndikojnë në sigurinë e avionëve.

Neni 8

Pezullimi ose anulimi i regjistrimit

1. AAC-ja, me njoftim me shkrim drejtuar operatorit të fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar, mund të pezullojë ose anulojë regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit, nëse ka baza të arsyeshme për të besuar, se:

a) fusha e fluturimit dhe terreni nuk plotëson asnjë nga standardet e aplikueshme në bazë të aneksit I dhe II të kësaj Rregulloreje.

b) operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar refuzon t'i japë akses personelit të autorizuar të AAC-së në infrastrukturë, objektet, shërbimet, dokumentet dhe personelin, për të ushtruar inspektime, në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe çdo kërkesë tjetër të zbatueshme për regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit.

c) operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit ka dështuar përmbushjen e kërkesave sipas neneve 9, 10, të kësaj Rregulloreje.

2. Përpara pezullimit ose anulimit të regjistrimit, AAC-ja duhet:

a) t'i japë operatorit me shkrim një letër njoftimi ku të tregohet shkaku; dhe

i. të përcaktohen faktet dhe rrethanat, të cilat, sipas mendimit të AAC-së, justifikojnë pezullimin ose anulimin; dhe

ii. të ftohet operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit për të treguar me shkrim, brenda 30 ditëve pas datës së njoftimit, shkaqet pse regjistrimi nuk duhet të pezullohet ose të anulohet; dhe

b) të marrë parasysh çdo kërkesë me shkrim që zotëruesi i bën AAC-së brenda kohës së lejuar sipas shkronjës (a) (ii) të kësaj pike.

3. Nëse operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar dëshiron të anulojë regjistrimin, operatori duhet t'i japë njoftim me shkrim AAC-së të paktën 60 ditë përpara nga data në të cilën operatori dëshiron që regjistrimi të anulohet.

Neni 9

Menaxherët raportues

1. Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar duhet të emërojë një ose më shumë menaxherë raportues për fushën e fluturimit dhe terrenit.

2. Menaxheri raportues duhet të ketë:

a) njohuri mbi standardet të cilave duhet t'i përmbahet fusha e fluturimit dhe terreni;

b) përgjegjësi në kryerjen e inspektimeve të rregullta mbi gjendjen e shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit dhe elementeve të lidhura me sigurinë në operim të fushës së fluturimit dhe terrenit;

c) të kenë aftësi komunikuese të të folurit dhe të të shkruarit për t'iu komunikuar gjendjen e kushteve të fushës së fluturimit dhe terrenit pilotëve dhe përdoruesve të tjerë të fushës së fluturimit dhe terrenit.

3. Përpara funksioneve raportuese, operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurohet se personi të cilit i besohen këto funksione është i trajnuar dhe ka njohuritë dhe eksperiencën e nevojshme, si dhe të përcjellë në AAC, jetëshkrimin, kualifikimet dhe trajnimet përkatëse.

4. Menaxheri raportues duhet të pajiset me radio të përshtatshme në mjetet e tyre (*trunk radio*) ose radio portative në mënyrë që, gjatë orëve të punës, të mbajnë kontakt mbi operimet e avionëve në fushën e fluturimit dhe terrenit.

5. Në rast se menaxheri raportues kryen inspektimet e sigurisë duhet të ketë:

a) diplomë në inxhinieri civile, gjeodezi apo një fushë e lidhur dhe dëshmon njohuri të plota të pjesëve të kësaj Rregulloreje dhe standardeve, praktikave dhe procedurave që janë të aplikueshme për operimin dhe mirëmbajtjen e fushave të fluturimit dhe terreneve;

b) eksperiencë punë minimalisht 3 vjet në profesion dhe njohuri në fushën e aviacionit.

6. Me qëllim verifikimin e zbatueshmërisë së pikës 5, në shkronjës “a” të saj, AAC-ja mund të kërkojë të intervistojë personin që kryen inspektimet e sigurisë me qëllim vlerësimin dhe verifikimin e njohurive.

Neni 10

Inspektimet e sigurisë (*safety*)

1. Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar duhet të organizojë kryerjen, të paktën një herë në vit, të një inspektimi sigurie të fushës së fluturimit dhe terrenit.
2. Inspektimi i sigurisë duhet të kryhet nga një person i kualifikuar sipas nenit 9, pika 5.
3. Personi që kryen inspektimin e sigurisë duhet t'i japë operatorit një raport me shkrim, që:
 - a) merret me çështjet e parashtruara në standardet e kësaj Rregulloreje; dhe
 - b) specifikon çdo punë riparuese që është e nevojshme për fushën e fluturimit dhe terrenit në përputhje me standardet e aplikueshme.
4. Brenda 30 ditëve pas marrjes së raportit, operatori duhet t'i japi AAC-së:
 - a) një kopje të raportit; dhe
 - b) nëse raporti specifikon ndonjë punë përmirësuese të nevojshme duhet të japë një deklaratë se kur dhe si operatori ka ndërmend të bëjë punët riparuese.

Neni 11

Standardet e aplikueshme për fushat e fluturimit dhe terreneve të regjistruara

Standardet e aplikueshme për fushat e fluturimit dhe terreneve të regjistruara janë standardet e përcaktuara në aneksin I dhe në aneksin II të kësaj Rregulloreje.

ANEKSI I

STANDARDET MINIMALE PËR OPERIMIN E FUSHAVE TË FLUTURIMIT DHE TERRENEVE TË REGJISTRUARA

A1 - 1 Të përgjithshme

A1- 1.1 Hyrje

A1 - 1.1.1 Shërbimet (fasilitetet) e fushës së fluturimit dhe terrenit, si dhe procedurat e operimit duhet të ruhen konform kushteve të përcaktuara në dokumentin e regjistrimit.

A1 - 1.1.2 Operatorët e fushave të fluturimit dhe terreneve të regjistruara duhet të kenë personel dhe procedura për të kryer në kohë inspektime mbi gjendjen e shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit, si dhe të identifikojnë rrethanat e ndryshuara dhe të bëjnë raporte.

A1 - 1.1.3 Nëse një fushë fluturimi dhe terreni e regjistruar dështon në arritjen e kërkesave të sigurisë në operim, AAC-ja mund të pezullojë ose të anulojë regjistrimin. Stafi i AAC-së mund të kryejë inspektime të njoftuara ose të panjoftuara të fushës së fluturimit dhe terrenit për të vlerësuar nëse përmbush apo jo kërkesat e sigurisë në operim.

A1 - 1.1.4 Standardet dhe procedurat e këtij kapitulli kanë si qëllim të ndihmojnë operatorin të arrijë kërkesat e vazhdueshme të sigurisë në operim.

A1 - 1.1.5 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të hartojë dhe të përcjellë për pranim pranë AAC-së procedurat e operimit dhe mirëmbajtjes së fushës së fluturimit.

A1 - 1.1.6 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurohet që operimi dhe mirëmbajtja e fushës së fluturimit dhe terrenit kryhet në përputhje me procedurën e operimit dhe mirëmbajtjes të pranuar nga AAC-ja.

A1 - 1.1.7 Operatorët ajror duhet të hartojnë planet e tyre të fluturimit dhe të sigurojnë që kushtet meteorologjike janë të përshtatshme për tipin e operimit që do të kryhet përpara realizimit të fluturimit për/nga fusha e fluturimit dhe terrenit.

A1 - 1.1.8 Operatori i fushës duhet të sigurohet se, para fillimit të operimeve është kryer nga operatori i avionit, një vlerësim paraprak mbi përshtatshmërinë e kushteve të fushës së regjistruar për llojin e operimit që synohet të realizohet.

A1 - 1.1.9 Mjetet e ndihmës së shpejtë mund të sigurohen në fushën e fluturimit dhe terrenit, si dhe operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit ka marrëveshje me qendrat lokale mjekësore për sigurimin e këtyre mjeteve në raste emergjence.

A1- 1.2 Inspektimet e gjendjes së shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit

A1 - 1.2.1 Inspektimet e gjendjes së shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit janë kontrole vizuale të elementeve të fushës së fluturimit dhe terrenit, të cilat mund të kenë një ndikim në sigurinë në operim të avionëve. Një listë kontrolli e elementeve që kontrollohen gjatë inspektimit duhet të zhvillohet në përputhje me përmasat dhe kompleksitetin e fushës së fluturimit dhe terrenit, si dhe të përdoret nga stafi përgjegjës dhe të ruhen evidenca.

A1 - 1.2.2 Inspektimi vizual i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të kryhet nga personat e autorizuar çdo ditë para fluturimeve dhe përsëri nëse ka raportime për FOD (objekte të huaja) në pistë.

A1 - 1.2.3 Për pistat me terren të fortë (jo me bar) një fokus i veçantë duhet t'i kushtohet FOD (objekteve të huaja). Zonat e dëmtuara duhet të riparohen sa më shpejt të jetë e mundur.

A1 - 1.2.4 Lista e kontrollit duhet të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:

- a) kushtet e sipërfaqes në zonën e lëvizjes, përfshirë pastërtinë;
- b) kushtet e sipërfaqes së pistës dhe zonave të sigurisë (STRIP & RESA);
- c) shenjat, shënjesat, treguesin e drejtimit të erës;
- d) çdo pengesë e cila mund të penetrojë sipërfaqet e afrimit dhe ngritjes në fluturim;
- e) aktivitetin e kafshëve apo zogjve në fushën e fluturimit dhe terrenit dhe në zonat përreth;
- f) kontrolli i gardheve ose mjeteve të tjera që parandalojnë personat dhe mjetet që lëvizin në zonën e lëvizjes.

A1- 1.3 Frekuenca e inspektimeve të gjendjes së shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit

A1 - 1.3.1 Në një fushë fluturimi dhe terren, inspektimet e gjendjes së shërbimit duhet të zhvillohen çdo ditë përpara operimeve.

A1 - 1.3.2 Inspektime shitesë mbi disponueshmërinë duhet të kryhen pas fenomeneve të rëndësishme të motit, si p.sh. erëra të forta ose shira të rrëmbyeshëm.

A1 - 1.3.3 Në një fushë fluturimi dhe terreni pa operime të rregullta të transportit publik ditor, inspektimet mbi disponueshmërinë e shërbimit duhet të kryhen përpara çdo veprimi të transportit ajror ose jo më pak se dy herë në javë.

A1 - 1.4 Regjistrimet e inspektimeve dhe mirëmbajtjes

A1 - 1.4.1 Operatori i një fushe fluturimi dhe terreni të regjistruar duhet të ruajë një regjistër inspektimi për të treguar se inspektimet janë kryer. Përveç regjistrimit të inspektimeve, duhet gjithashtu të regjistrojë mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese që i bëhet fushës së fluturimit dhe terrenit.

A1 - 1.4.2 Regjistri duhet të mbahet për të paktën 24 muaj ose për periudhën për të cilën është rënë dakord për inspektimet e sigurisë në operim të fushës së fluturimit dhe terrenit, nëse kjo periudhë është më e gjatë se 24 muaj. Regjistri duhet të jetë i disponueshëm për çdo person të autorizuar të

AAC-së, që kryen inspektimin e fushës së fluturimit dhe terrenit dhe për çdo person, i cili kryen inspektimin periodik vjetor të sigurisë në operim të fushës së fluturimit dhe terrenit.

A1 - 1.5 Punimet në fushën e fluturimit dhe terrenit

A1 - 1.5.1 Punimet në fushën e fluturimit dhe terrenit duhet të organizohen në mënyrë që të mos krijojnë ndonjë rrezik ndaj avionit ose konfuzion për pilotët.

A1 - 1.5.2 Punimet në fushën e fluturimit dhe terrenit duhet të kryhen, pasi sigurohen masa parandaluese, vlerësohet risku dhe njoftohet AAC-ja.

A1- 1.6 Raportet e inspektimit të sigurisë

A1 - 1.6.1 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit të regjistruar duhet të përgatisë dhe të përcjellë në AAC çdo vit, ose për një periudhë tjetër për të cilën është rënë dakord, një inspektim të sigurisë në operim.

A1 - 1.6.2 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurojë se sipërfaqet e afrimit dhe ngritjes në fluturim janë të lira nga pengesat ose të shenjuara në rastet kur është e pamundur që këto pengesa të hiqen.

A1 - 1.6.3 Është në interesin e operatorit të fushës së fluturimit dhe terrenit dhe operatorëve ajrorë që një procedurë të zhvillohet për pilotët që operojnë në këtë fushë duke iu treguar disponueshmërinë e faciliteteve, procedurat e afrimit, uljes/ngritjet dhe ndërgjegjësim mbi rreziqet që lidhen me këtë fushë. Detyrimi për të marrë leje nga operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit para uljes në fushën e fluturimit dhe terrenit mund të shërbejë si mjeti për ndërgjegjësimin e pilotit që do të operojë në këtë fushë fluturimi dhe terreni mbi rreziqet apo informacione të tjera, në lidhje me operimin në këtë fushë fluturimi dhe terreni. Ky informacion mund të publikohet edhe në faqen e *web*-it të fushës së fluturimit dhe terrenit.

A1 - 1.6.4 Bazuar në informacione të disponueshme të siguruar nga operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit, operatorët ajrorë mund të zhvillojnë një procedurë standarde operimi, në rast se operimi në fushën e fluturimit dhe terrenit nuk është i limituar për një herë të vetme.

A1 - 1.6.5 Çdo objekt që mund të përbëjë një rrezik për uljen dhe ngritjen e avionëve, pavarësisht lartësisë ose pozicionit, duhet të minimizohet ose të hiqet. Në rast se kjo nuk është e mundur, duhet që administratori i fushës së fluturimit dhe terrenit të sigurohet që këto objekte janë shënjuar me shënjesa, sipas kërkesave të zbatueshme për shënjimin e pengesave në Republikën e Shqipërisë.

A1 - 1.6.5 Në fushat e fluturimit dhe terrenit të regjistruara, zona e afrimit dhe e ngritjes në fluturim duhet të kontrollohen mbi një bazë të rregullt kohore për rritjen e bëmësisë ose për objekte të reja të larta. Kur një pengesë tjetër mund të bëhet kritike dhe mund të ndikojë në sigurinë në operim, kontrolli duhet të kryhet nga një person me aftësi teknike të përshtatshme.

A1 - 1.6.7 Operatori i fushave të fluturimit dhe terrenit duhet të sigurohet para çdo operimi të programuar, që të kryhet kontrolli i aktivitetit të zogjve dhe të merren masa për reduktimin e këtij aktiviteti, duke mundësuar sigurinë në operim.

A1 - 1.7 Raportimi mbi gjendjen e shërbimit të avionit

A1 - 1.7.1 Nëse fushat e fluturimit dhe terrenit nuk kanë informacion të publikuar në AIP ose nuk janë pajisur me një shërbim NOTAM, operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të vendosë një sistem raportimi të tillë, që piloti të mund të njoftohet për çdo ndryshim mbi gjendjen e shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit, mundësisht përpara imbarkimit në një udhëtim.

A1 - 1.7.2 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit ka si detyrë të sigurojë informacion, i cili duhet të jetë sa më i saktë të jetë e mundur. Kjo do të kërkonte inspektim fizik të fushës së fluturimit dhe terrenit, mundësisht përpara nisjes së avionit nga aerodromi i nisjes, por gjithmonë përpara mbërritjes së avionit. Për të ruajtur një saktësi të gjendjes së shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit, është thelbësore që fusha e fluturimit dhe terrenit të inspektohet pas shiut ose erës së fortë. Informacioni i siguruar duhet të përmbajë:

- a) kushtet e sipërfaqes së pistës: e thatë, e lagur, e butë, e rrëshqitshme;
- b) kushtet e rripit të pistës: çdo pengesë, ashpërsi të papërshtatshme, dukshmëria ose shenjat;
- c) treguesi i drejtimit të erës: nëse është grisur apo penguar;
- d) zonat e afrimit dhe të ngritjes në fluturim: nëse ka objekte afër ose lart sipërfaqeve të pengesave;
- e) kushte të tjera të rrezikshme ose objekte të njohura për operatorin, p.sh. rreziqe nga kafshët apo zogjtë.

A1 - 1.7.3 Nëse një informacion i fushës së fluturimit dhe terrenit nuk është publikuar në AIP, manuali i operimeve të operatorit të fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të tregojë qartësisht informacionin e fushës së fluturimit dhe terrenit dhe detajet e kontaktit për raportet e gjendjes së shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit.

A1 - 1.7.4 Kur fusha e fluturimit dhe terrenit konsiderohet si shumë e lagur për operimet e avionit, operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të shfaqë sinjale të mosfunksionimit dhe të njoftojë operatorët ajrorë që operojnë aty. Kur ka dyshime, gjithmonë duhet vepruar në interes të garantimit të sigurisë në operim.

A1 - 1.8 Shërbimi i shpëtimit dhe fikjes së zjarrit

A1 - 1.8.1 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurohet që përpara çdo fluturimi të jetë në dispozicion në fushën e fluturimit dhe terrenit sa më poshtë:

- a) Një mjet RFFS-je me aftësi për të mbajtur personelin dhe pajisjet për të luftuar zjarrin;
- b) Një fikës zjarri me shkumë që përmban jo më pak se 90 L shkumë të performancës së kategorisë B me një nivel shkarkimi jo më pak se 60L/m me një ose më shumë dalje.

A1 - 1.8.2 Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurojë disponueshmërinë e agentit plotësues në shkumë prej 14 kg pudër të thatë ose bromoklorodifluormetan (BCF), ose 25 kg CO₂.

A1 - 1.9 Furnizimi me karburant i avionit

A1 - 1.9.1 Magazinimi dhe shpërndarja e karburantit nga një fushë fluturimi dhe terreni kërkon që operatori i fasilitetit të karburantit të disponojë licencat apo autorizimet përkatëse për të kryer këtë shërbim, të lëshuar nga autoritetet përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

ANEKSI II

STANDARDET MINIMALE PËR NDËRTIMIN E FUSHAVE TË FLUTURIMIT DHE TERRENIT

A2 - 1 Gjatësia e pistës: Gjatësia e pistës duhet të jetë e përshtatshme për avionët që synohet të operojnë dhe të cilëve fusha e fluturimit dhe terrenit synohet t'i shërbejë. Gjatësia e fushave të fluturimit, duhet të jetë në përputhje me kërkesat minimale të vendosura në rregulloren për certifikimin e aerodromeve, sipas aneksit 14, vëllimi 1 i ICAO-s.

A2 - 2 Gjerësia e pistës: Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurojë një gjerësi minimale prej 23 m për avionë.

A2 - 3 Orientimi i pistës: Gjatë projektimit të pistës duhet të konsiderohen dhe efekti i erërave lokale. Operatori i fushës së fluturimit dhe terreneve mund të konsiderojë një ndryshim në orientimin e pistës me 10–20 gradë për të reduktuar efektin e erërave anësore. Gjithashtu, gjatë projektimit të një piste duhet të konsiderohet efekti potencial i ndërtesave, pemëve apo objekteve natyrore në lidhje me erërat sipërfaqësore lokale.

A2 - 4 Pjerrësitë e pistës: Gjatë projektimit të pistës së fushës së fluturimit dhe terrenit, duhet të sigurohet që orientimi i rripit të pistës të jetë i tillë që të eliminohen pjerrësitë anësore të mëdha. Pjerrësisë gjatësore dhe tërthore të pistës të limitohen në një maksimum prej 2%.

A2 - 5 Sipërfaqja e pistës: Sipërfaqja e pistës nuk duhet të ketë parregullsi të cilat mund të kenë efekte negative për ngritjen dhe uljen e një avioni. Gjithashtu, operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurohet që pista të jetë e drenazhuar. Sipërfaqet e forta të pistës duhet të inspektohen

rregullisht për FOD (të paktën një herë në ditë, ose para çdo fluturimi), dhe sipërfaqet me bar të pistës duhet të korren, të nivelohen dhe të mbahen të pastra nga objektet e huaja. Operatori i fushës së fluturimit dhe terreneve duhet të sigurohet që për sipërfaqen e pistës të përdorë farat për mbirje bari me rritje të ngadaltë dhe që parandalon rrëshqitjen e avionit ose daljen nga pista. Bari duhet të mbahet në një gjatësi maksimale prej 10 centimetra. Një testim empirik për cilësinë e pistës duhet të kryhet nga operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit nëpërmjet ngjarjes së një mjeti të ngurtë si p.sh. një kamion me përmasa mesatare përgjatë pistës në një shpejtësi jo më pak se 65 km/orë. Nëse xhiroja me këtë kamion është e parehatshme për pasagjerët, atëherë sipërfaqja duhet të përmirësohet dhe të nivelohet.

A2 - 6 Rripi i pistës dhe objektet në të: Rripi i pistës duhet të sigurohet pavarësisht tipit të operimeve që synohet të kryhen në këtë fushë fluturimi dhe terreni. Gjatësia e rripit të pistës, duhet të jetë minimalisht 30 m dhe gjerësia e rripit të pistës nga vija qendrore e pistës duhet të shtrihet në një distancë minimale prej 30 m. Kur ajo synohet të përdoret për qëllime trajnimit në fluturim, gjatësia e rripit të pistës duhet të jetë minimalisht 60 m dhe gjerësia e rripit të pistës nga vija qendrore e pistës duhet të shtrihet në një distancë minimale prej 40 m. Rripi i pistës duhet të mbahet i niveluar dhe i pastër nga vegetacioni. Rripi i pistës duhet të jetë në të njëjtin nivel me sipërfaqen e pistës, duke mundësuar minimizimin e dëmtimeve të avionit në rastet e daljes së paqëllimshme nga pista. Një objekt i ndodhur në rripin e pistës, i cili mund të dëmtojë avionët duhet të konsiderohet si pengesë dhe duhet, aq sa është e mundur, të hiqet. Gjithashtu, objektet e palëvizshme të cilat kërkojnë për arsye të sigurisë së avionëve dhe të cilat duhet të lokalizohen në rripin e pistës dhe përmbushin kërkesën e thyeshmërisë, lejohen të pozicionohen në rripin e pistës. Asnjë objekt i lëvizshëm nuk lejohet të pozicionohet në rripin e pistës gjatë uljeve dhe ngritjeve të avionëve.

A2 - 7 Zona e Sigurisë në fund të pistës: Zona e sigurisë në fund të pistës duhet të sigurohet pavarësisht tipit të operimeve që synohet të kryhen në këtë fushë fluturimi dhe terreni dhe duhet të shtrihet në një distancë minimalisht prej 30 m nga fundi i rripit të pistës. Gjerësia e Zonës së Sigurisë në fund të pistës duhet të jetë minimalisht sa dyfishi i gjerësisë së pistës.

A2 - 8 Rrugët lidhëse: Aty ku sigurohen, rrugët lidhëse duhet të përmbushin karakteristikat e performancës së avionëve për hyrjen dhe daljen nga pista dhe duhet të jenë të pajisura me udhëzime për lëvizjen në tokë të avionëve.

A2 - 9 Vendqëndrimet: Aty ku sigurohen, vendqëndrimet e avionëve duhet të jenë të një madhësie të mjaftueshme për të lejuar parkimin e avionëve pa shkaktuar interferencë në operimin e avionëve.

A2 - 10 Vijëzimet dhe shënjesit

A2 - 10.1 Vijëzimet e pistës: Pista duhet të pajiset me vijëzimet anësore, vijëzimet e pragut të pistës, si dhe numrin identifikues të pistës. Vijëzimet anësore duhet të jenë në formë drejtkëndore dhe të lyera me bojë të bardhë, në të njëjtin nivel me sipërfaqen e pistës, 3 metra të gjata dhe 1 metër të gjera, të vendosura në interval prej jo më shumë se 90 metra. Në mënyrë alternative, shenja të përshtatshme të ngritura të thyeshme (si p.sh. konet e trafikut) të vendosura në interval të njëjta si më lart, mund të përdoren. Fundet e pistës mund të vijëzohen me vijëzim me bojë të njëjtë duke iu bashkuar vijëzimeve anësore fundore në një kënd të drejtë. Për më shumë informacion referohuni ICAO Doc 9157, pjesa 4 "*Aerodrome Design Manual*".

A2 - 10.2 Kur skajet e një rruge lidhëse ose rripat e rrugëve lidhëse mund të mos jenë të qarta nga ana vizuale, vijëzimet/shënjesit e skajeve të rrugëve lidhëse duhet të sigurohen në mënyrë të tillë që t'u tregojnë pilotëve skajin e rrugës lidhëse.

A2 - 10.3 Aty ku janë siguruar shenjues për rrugën lidhëse, këta shenjues duhet të jenë konikë dhe të verdhë dhe duhet të kenë një hapësirë në mënyrë që pilotët të mund të përcaktojnë skajin e rrugës lidhëse të paasfaltuar.

A2 - 10.4 Kur skajet e një vendqëndrimi të paasfaltuar mund të mos jenë të qarta për pilotët, duhet të sigurohen vijëzime/shënjes për skajet e vendqëndrimit.

A2 - 10.5 Aty ku sigurohet pajisja me shenjues për skajet e vendqëndrimit, këta shënjes duhet të jenë të verdhë dhe konikë dhe duhet të kenë një hapësirë në mënyrë që pilotët të mund të përcaktojnë qartë skajin e zonës së vendqëndrimit të paasfaltuar.

A2 - 11 Treguesi i drejtimit të erës: Operatori i fushës së fluturimit dhe i terrenit duhet të sigurojë vendosjen e treguesit të drejtimit të erës që të jetë lehtësisht i dukshëm nga ajri dhe i pozicionuar në një mënyrë të tillë, që të tregojë qartësisht drejtimin dhe shpejtësinë e erës. Operatori duhet të shmangë pozicionimin e treguesit të drejtimit të erës pranë pemëve, godinave apo zonave të tjera, që të mos impaktojë në funksionimin e tij, si dhe të sigurojë që treguesi i drejtimit të erës nuk interferon me uljen e avionëve gjatë uljes dhe ngritjes.

A2 - 12 Gardhi: Operatori i fushës së fluturimit dhe terrenit duhet të sigurojë pajisjen e fushës së fluturimit me një gardh apo me një barrierë të përshtatshme për të parandaluar në zonën e lëvizjes, hyrjen e kafshëve që mund të përbëjë rrezik për avionët.

A2 - 13 Pengesat: Çdo objekt, që për shkak të lartësisë apo pozicionimit të tij mund të përbëjë një rrezik për uljen apo ngritjen e avionëve, duhet të shënjohej me shenja të dukshme, nëse është e pamundur që të hiqet.

A2 - 14 Përmasat fizike dhe sipërfaqet me kufizim pengesash (OLS) përcaktohen në tabelën 1-1.




Figura 1-1: Sipërfaqet e kufizimit të pengesave

Sipërfaqet e pistës dhe kufizimit të pengesave		Avionë që i kalojnë 2000 kg, por që nuk i kalojnë 5700 kg (gjatë ditës)
Sipërfaqja konike		
Pjerrësia		5%
Lartësia		55 m
Sipërfaqja e brendshme horizontale		
Lartësia		45 m
Rrezja		2000 m

Sipërfaqet e afrimit dhe të ngritjes në fluturim	
Gjatësia e skajit të brendshëm	60 m
Distanca e skajit të brendshëm përpara pragut	30 m
Divergjenca, çdo anë	10%
Gjatësia e sipërfaqes	1600 m
Pjerrësia	5%
Sipërfaqet e kalimit	
Pjerrësia (deri 45 m lartësi)	20%

Tabela 1-1: Standardet për sipërfaqet me kufizim pengesash

A2 - 15 Pengesat në OLS: Çdo objekt që penetron në sipërfaqet e mësipërme duhet të hiqet. Në rast se është e pamundur që ky objekt të hiqet, ai duhet të shënjohe.

A2 - 16 Vendosja e objekteve të reja apo zgjatimi i atyre ekzistues lejohet vetëm nëse një studim aeronautik tregon se nuk ndikohet siguria në operim.

Shtojca I: Kërkesë për regjistrimin e fushës së fluturimit dhe terrenit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Aplikim për Regjistrim të fushës së fluturimit dhe terrenit

Application to Register an Airfield

1. Të dhëna mbi aplikuesin / Particulars of the Applicant

Emri i plotë i aplikuesit:

Full name of the applicant:

Adresa/ Address:

Kodi Posal / Postcode:

Pozicioni / Position:

Tel. / Phone:

Fax:

E-mail:

2. Të dhëna të fushës së fluturimit dhe terrenit / Particulars of the Airfield

Emri i Fushës së fluturimit dhe terrenit/Name of airfield:

Përshkrimi i pronës së patundshme/Real property description:

Afersia ose distanca nga qyteti më i afërt ose zona të populluar:

Bearing or distance from nearest town or populous area:

3. Është Aplikuesi Pronar i Vendndodhjes së fushës së fluturimit dhe terrenit

Is the Applicant the Owner of the Airfield Site?

PO / Yes ☐

(kalo tek pika 4) JO / No ☐

Nëse JO dëshmoni:

If NO provide:

a) Detajet e të drejtave mbi fushën e fluturimit dhe terrenit; dhe

Details of Rights held in Relation to the Site; and

b) Emri dhe adresa e pronarit të pronës së patundshme dhe një evidence të shkruara që vërtetojnë që leja është marrë për vendndodhjen që të përdoret si fushë fluturimi dhe terreni.

Name and address of the owner of the site and written evidence to show that permission has been obtained for the site to be used as an airfield.

4. Informoni për modelin e aeroplanit më të madh që pritet ta përdorë fushën e fluturimit dhe terrenit:

Indicate the Largest Type of the Aircraft Expected to Use the Airfield:

5. Cila mendoni se do të jetë frekuenca e operimeve në këtë fushë?

What is the intended frequency of the operations?

6. Te dhenat e Fushës së fluturimit dhe terrenit/ Airfield Data

Nëse nuk është e aplikueshme, vendos N/A në kutinë në të djathtë:

If not applicable, insert N/A in the box on the right:

Njoftime të të Dhënave të Fushës së fluturimit dhe terrenit

Report on Airfield Data

6a. Diagrama e Fushës së fluturimit dhe terrenit / Airfield Diagram



Ky diagram tregon si më poshtë:

This diagram depicts the following:

- (i) plan vendndodhja e pistës, tregimi magnetik dhe gjatësia në metra;
(i) The runway layout, their magnetic bearing and length in metres;
- (ii) plan vendndodhja e rrugëve lidhëse dhe vendqendrimëve;
(ii) The layout of the taxiways and aprons;
- (iii) Vendndodhja e pikës së referimit të fushës së fluturimit dhe terrenit;
(iii) The location of the airfield reference point;
- (iv) vendndodhja e treguesit të drejtimit të erës, të ndriçuar ose të pandriçuar;
(iv) The location of the wind direction indicators, both lit and unlit;
- (v) lartësia e fushës së fluturimit dhe terrenit (pikë më e lartë mbi sipërfaqen ujit, në metra);
(v) The elevation of the airfield (the highest point on the landing surface in meter);
- (vi) Tregimi magnetik dhe distanca më të afërt me qendrën e qyteti apo zonë të populluar.
(vi) The magnetic bearing and distance to the nearest city, town or population center.

6b. Vendndodhja e Fushës së fluturimit dhe terrenit / Airfield Location: (ARP)

Lat:

Long:

6c. Administrimi i Fushës së fluturimit dhe terrenit (Siguro informacionin e mëposhtëm në lidhje me pronarin e fushës së fluturimit dhe terrenit.)

Airfield Administration *(Provide the following information on the aerodrome owner.)*

Emri i Fushës së fluturimit dhe terrenit:

Name of Airfield:

.....

Emri i operatorit të Fushës së fluturimit dhe terrenit:

Name of Airfield Operator:

.....

Adresa:

Address:

.....

Tel: (24h)..... Fax

Shteti në të cilën është vendosur Fusha e fluturimit dhe terrenit:

State in which the Airfield is Located:

.....

Qëllimi i përdorimit të fushës:

.....

Cili është (janë) Menaxheri (ët) Raportues të Fushës së fluturimit dhe terrenit?

Të dhënat:

6d. Shërbimet në Tokë / *Ground Services* nëse është e zbatueshme

(Siguro informacionin e mëposhtëm mbi shërbimet në dispozicion të pilotëve.)

(Provide the following information on services available to pilots.)

Tipi i karburantit/ *Fuel Type*:
 Ofruesi/ *Supplier*:
 Tel: (O/P)/(B/H).....(P/P)/(A/H).....
 Fasilitetet meteorologjike në dispozicion/ *Met Facilities Available*: Po/Yes ☐ Jo /No ☐
 TAF Kategoria/ *Category*:..... AWIS Nr. Tel. /*Phone Number*:.....AwIS
 Frekuenca/ *Frequency*:.....
 CTAF ose MBZ në dispozicion/ *CTAF or MBZ available*: Po/Yes ☐ Jo /No ☐
 CTAF: MBZ: UNICOM: AFRU:
 Fasilitetet e ndihmës së navigimit në dispozicion/ *Navaid Facilities Available*: Po/Yes ☐ Jo /No ☐
 Tipi/ *Type*:..... Koordinatat e Kodit/ *Code Coordinates*:.....
 Diapazoni/ *Range*:.....
 Monitorimi/ *Monitoring*:.....
 Fasilitetet e komunikimit ATS në dispozicion/ *ATS Communication Facilities Available*: Po/Yes ☐ Jo /No ☐
 Në tokë/ *On Ground*:..... Qarkore/ *Circuit*:.....
 Fasilitetet e pasagjerëve në dispozicion/ *Passenger Facilities Available*: Po/Yes ☐ Jo /No ☐

6e. Special Procedures / Procedura Speciale:

(Siguro informacionin e mëposhtëm në lidhje me çdo procedurë e veçantë që pilotët të kenë nevojë për të vëzhguar apo ndjekur.)
(Provide the following information about any special procedures that pilots need to observe or follow.)

Aplikohen procedura të veçanta/ *Special Procedures Apply*: Po/Yes ☐ Jo /No ☐

6f. Njoftime / Notices:

(Provide the following information on any local safety information.)

Detaje për ndonjë pengesë/ *Details of any Obstacles*:

 Detaje për rreziqe/ *Details of any Hazards* (eg, birds or animals):

 Detaje për çdo kufizim për përdorimin e rrugëve lidhëse apo vendqëndrimeve/ *Details of any Restrictions on the use of Taxiways or Aprons*:

 Detaje për çdo aktivitet tjetër në fushë/ *Details of any other activities at the airfield* (eg, sport aviation activities):

Firma e subjektit që aplikon Date..... /____/
Approved person's signature